



REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / KOSOVA CUMHURIYETI

C.nr.109/05

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Valon Totaj, me procesmbajtësen Drita Qerreti, në çështjen juridike të paditësit P.-C. B.- K. në Prizren, të cilën e përfaqëson K. K., kundër të paditurve N. A. nga fshati ... Komuna Prizren të cilin e përfaqëson av. N. Q. nga Prizreni, F. A. nga fshati ... komuna e Prizrenit, si dhe Sh. K. nga fshati komuna e Prizrenit, për shkak të mos pagesës së borxhit, vlera e kontestit 5.601,77 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën 26.09.2014, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit P.-C. B. – K., si e bazuar.
- II. DETYROHEN** të paditurit N. A. nga fshati ... komuna e Prizrenit, F. A. nga fshati ... komuna e Prizrenit, si dhe Sh. K. nga fshati ... komuna e Prizrenit, që në emër të borxhit, në mënyrë solidare t'ia paguajnë paditësit shumën në lartësi prej 5,601.77 €, si dhe që në emër të shpenzimeve të procedurës në mënyrë solidare t'ia paguajnë paditësit shumën në lartësi prej 138,80 €, të gjitha këto në afatin prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje kontestimore është mbajtur në mungesë të të paditurit të parë N. A. dhe të paditurit të tretë Sh. K., konform nenit 423 parag. 4 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Në Gjykatën Themelore në Prizren, është iniciuar procedura civile kontestimore sipas padisë së paditësit P. C. B. K. në Prizren, kundër të paditurve N. A., F. A. dhe Sh. K., për shkak të borxhit në shumën prej 6,755.77 euro.

Përfaqësuesi i paditësit P. C. B., K. K., përgjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë së precizuar të datës 18.07.2014. Në fjalën e tij të fundit ka theksuar se i padituri i parë N. A., ka marr kredi tek paditësi më datën 22.10.2002, përmes marrëveshjes me nr. Nr. B-2003, në shumë prej 50,000.00 euro, ndërsa që i padituri i dytë F. A. ka qenë bashkëhuamarrës, kurse i padituri i tretë Sh. K. ka qenë garantues në kredinë e të paditurit të parë dhe të dytë. Më tej ka shtuar se i padituri i parë N. A., në mënyrë të rregullt e ka bërë tërheqjen e kredisë, me qëllim zhvillimin optimal të

biznesit të tij. I padituri N. A. e ka bërë pagesën e një pjese të borxhit sipas kësteve të parapara me aneksin (planin e pagesës) të marrëveshjes mbi kredinë B-2003, të datës 20.10.2002, sipas të cilës të paditurit të parë i është lejuar huaja apo kredia në vlerë prej 50.000,00 euro dhe të cilin borxh i padituri i parë nuk e ka përmbushur në tërësi, ngase ka mbetur pa u përmbushur edhe pjesa në shumë prej 5601,77 euro, e cila shumë konsiston në tri këstet e fundit të kredisë. Mbi bazën e të lartëcekurave i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj në tersi kërkesëpadinë e paditësit dhe t'i obligoj të paditurit që në mënyrë solidare t'ia paguajnë paditëses shumen në lartësi prej 5601,77 euro, si dhe taksën gjyqësorë, në emër të paraqitjes së padis në gjykatë në shumë prej 138,80 euro, e krejt këtë duke marrë për bazë gjendjen financiare të paditurve. Përndryshe i autorizuari i paditësit nuk i ka llogaritur dhe nuk i ka kërkuar gjobat përkitazi me vonesën për kthimin e huas.

I padituri i dytë F. A. gjykatës nuk i'a ka parashtruar përgjigjen me shkrim në padi. Përgjatë shqyrtimit gjyqësor ai ka deklaruar se është e vërtetë se i padituri i parë N. A., ka marr kredi nga këtu paditësi ndërsa që ai vetëm formalisht dhe pa e ditur se qfarë pasoja mund të ketë, kishte hyrë në cilësin e bashkëhuamarrësit.

Gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike, gjykata ka administruar këto prova: marrëveshja mbi kredinë nr. B-2003, e datës 22.10.2002; garancioni i datës 22.10.2002, të nënshkruar nga garantuesi – këtu i padituri i tretë Sh. K.; konfirmimi i datës 28.06.2000, për regjistrimin e përkohshëm të subjektit afarist DPZ "K."; konfirmimi i datës 05.05.2000, për regjistrimin e përkohshëm të subjektit afarist për NTP " L."; gjendja e llogarisë e datës 26.03.2014, të ndërmarrjes "L.", për periudhën kohore nga data 13.05.2002, e deri më 26.03.2014; si dhe pagesa e klientit për kredi e të paditurit N. A., e datës 26.03.2014.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartëcekura, në kuptimin e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Nga leximi marrëveshjes mbi kredinë nr.B-2003, të datës, 22.10.2002, gjykata ka konstatuar se paditësi P. C. B. në Prizren, me të paditurit N. A. dhe F. A., kanë lidhur marrëveshjen për kredi, ku i padituri i parë N. A. ka marrë kredi në shumë prej 50.000,00 euro, ndërsa që e i padituri i dytë F. A. ka qenë në cilësi të bashkëhuamarrësit.

Nga leximi i fletëgarancionit, i nënshkruar më 22.10.2002, nga garantuesi Sh. K., përkatësisht këtu i padituri i tretë, gjykata ka konstatuar se i padituri i tretë Sh. K., ka qenë garantues në kredinë e të paditurve N. dhe F. A. në shumën prej 50.000,00 euro, ku me nënshkrimin e kësaj marrëveshje ai është bërë përgjegjës ndaj bankës për borxhet e huamarrësit.

Nga leximi i planit të pagesës së kredisë për të paditurit , të datës 22.10.2002, gjykata ka konstatuar se kthimin e kredisë, të paditurit kanë qenë të obliguar ta bëjnë në 24

(njëzetekatër) këste, dhe atë në shumë prej 2.502,58 euro për çdo muaj (këst), me datë 22 të secilit muaj vijues, duke filluar prej datës 22.11.2002, e deri më 22.10.2004.

Nga leximi në konfirmimin për regjistrim të përkohshëm të subjektit afarist të datës 05.05.2000 për NTP "L.", gjykata ka konstatuar se i padituri N. A. ka qenë pronar i subjektit afarist NTP "L." dhe se kredinë e të cilën e ka marr te këtu paditësi P. C. B., e kishte marrë me qëllim të udhëheqjes optimale të biznesit të tij.

Nga leximi në gjendjen e llogarisë të datës 26.03.2014, të ndërmarrjes "L." për periudhën nga 13.05.2002, e deri me 26.03.2014, gjykata ka konstatuar se në këtë llogari janë bërë lëvizje të pagesave të ndryshme qe kapin shumën përfundimtare prej 173,417.00 euro.

Nga leximi i pagesës së klientit për kredinë, të të paditurit N. A. të datës 26.03.2014, gjykata ka konstatuar se borxhi i tërësishëm i mbetur i të paditurve ndaj paditësit P. C. B. është shuma prej 5,601.77 euro.

Baza ligjore

Me nenin nenin 17 të Ligjit mbi Mardhëniet e Detyrimeve (LMD), është e paraparë se *"pjesëmarrësit e detyrimit kanë për detyrë që ta zbatojnë detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij"*, ndërsa me nenin 262 të po këtij ligji, është paraparë se *"kreditori në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij"*.

Vlerësimi përfundimtarë i gjykatës

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar në këtë procedurë, është vërtetuar se kërkespadija e paditësit është e bazuar dhe se e njëjta duhet të aprovohet në tërësi. Kjo ngase është provuar se i padituri i parë N. A., me datën 22.10.2002, e ka lidhur marrëveshjen për kredinë me paditësin P. C. B. me nr.B-2003, ku nga paditësi ai i kishte marrë kredi shumë prej 50,000.00 eurove, e të cilën kredi i padituri N. e kishte marrë për zhvillimin e biznesit afarist NTP "L.". Në bazë të kësaj marrëveshje del se i padituri i dytë F. A. ka qen bashkëhuamarrës, ndërsa i padituri i tretë Sh. K. ka qenë garantues i kësaj kredie. Bazuar në këtë marrëveshje për kredinë, të paditurit kanë qenë të obliguar që ta kthejnë kredinë me këste mujore dhe atë për 24 muaj përkatësisht prej datës 22.11.2002, deri me datën 22.10.2004, konform planit të pagesës të bashkangjitur marrëveshjes mbi kredinë. Në bazë të provave të administruara në këtë procedurë, është vërtetuar se pjesën më të madhe të kredisë dhe në afatin e paraparë me marrëveshje, e ka kthyer i padituri N. A., por se i njëjti nuk ka mundur që ta përmbushë të gjithë detyrimin e tij ndaj paditësit, dhe atë për tre këstet e fundit që kapin shumë e përgjithshme prej 5,601.77. euro. Gjendja e këtillë faktike është vërtetuar në bazë të provave të lartcekura të administruara në këtë procedurë, të cilave edhe ua fali besimin e plotë. Andaj mbi bazën e të lartcekurave gjykata vendosi që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoi në tërësi si të bazuar sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vlersuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, dhe ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë me ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 lidhur me nenin 485 të LPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 452.1 të LPK-së dhe atë për shpenzimet si në vijim: për përpilimin e padis shumë prej 138.80 euro.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.109/05, datë 26.09.2014

Procesmbajtësja,
Drita Qerreti

Gjyqtari,
Valon Totaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së të njejtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate